

10

ADHURIMI NË KISHËN E JEZUSIT (II)

Shumica e mësimeve të mëparshme u përqëndruan në katër shprehjet e adhurimit: Darka e Zotit, mësimi e predikimi i Fjalës së Perëndisë, lutja dhe kontributi. Në këtë mësim do të trajtojmë më me hollësi shprehjen e pestë, të kënduarit.

Të kënduarit ka qenë gjithmonë një shprehje e natyrshme e adhurimit. Në Dhjatën e Vjetër, Davidi tha: “Do të këndoje dhe do të kremtoj lëvdimet e Zotit” (Psalmeve 27:6c). Në Dhjatën e Re, të kënduarit është gjithashtu një shprehje e domosdoshme e adhurimit.

Të kënduarit duhet të përfshihet në axhendën e takimeve tona për adhurimin e Perëndisë. Jakobi shkroi: “A është i gëzuar ndokush? Le të këndoje psalme” (Jakobi 5:13b). Disa prej nesh kujtojnë prindërit apo gjyshërit duke kënduar ndërsa punonin.

Perëndia gjithashtu ka urdhëruar që të kënduarit duhet të jetë pjesë e adhurimit tonë në bashkësi. Te Hebrenjve 2:12b thuhet: “Do të lavdëroj në mes të kishës.”¹ Pali i urdhëroi kristianët në Efes t’i flisnin “njëri tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore” (Efesianëve 5:19a). Ai gjithashtu u tha anëtarëve të kishës në Kolose të mësonin dhe të këshillonin “njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore” (Kolosianëve 3:16). Kur Pali dha udhëzime për adhurimin në bashkësi te 1 Korintasve 14, ai tha se kristianët duhet të këndojnë “me frymën . . . edhe me mendjen” (1 Korintasve 14:15).

Në këtë mësim, theksi do t’i vihet adhurimit në bashkësi. Parimet e treguara këtu mund të aplikohen edhe për adhurimin personal.

ÇFARË DO PERËNDIA?

Në listën e vargjeve në Dhjatën e Re që flasin

për të kënduarit është edhe Marku 14:26, ku Jezusi dhe dishepujt e tij kënduan një himn para se të dilnin dhe të shkonin te mali i Ullinjve.² Në këtë listë është edhe Veprat 16:25, ku “Pali dhe Sila . . . i këndonin himne Perëndisë” në mesnatë. Më pëlqejnë këto vargje sepse më tregojnë se Jezusit dhe nxënësve të tij u pëlqente të këndonin ashtu siç më pëlqen edhe mua. Lista do të përfshinte edhe vargje të tjera përveç atyre që përmendëm:³

. . . sikurse është shkruar: “Për këtë do të të përlëvdoj ndër kombe, dhe do t’i këndoje lavdërime emrit tënd!” (Romakëve 15:9).

. . . do të këndoje me frymën, por do të këndoje edhe me mendjen (1 Korintasve 14:15).

“Vëllezërve të mi do t’ua shpall emrin tënd, do të të lavdëroj në mes të kishës” (Hebrenjve 2:12).

A vuan ndonjë nga ju? Le të lutet. A është i gëzuar ndokush? Le të këndoje psalme (Jakobi 5:13).

Dy vargje që përmbledhin ato që nevojitet të dimë për të kënduarit në adhurim janë Efesianëve 5:19 dhe Kolosianëve 3:16. Të dyja vargjet janë të ngjashme:

. . . duke i folur njëri tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj (Efesianëve 5:19).

Fjala e Krishtit banoftë në ju me begatinë e vet; në çdo dituri, mësoni dhe këshilloni njëri tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke këndur Zotit me hir në zemrat tuaja (Kolosianëve 3:16).

Këto vargje na mësojnë se Perëndia do që secili prej nesh të këndoje. Urdhri për të kënduar nuk u drejtohet vetëm disave që janë zgjedhur. Nuk u drejtohet vetëm atyre që kanë zë të bukur. Udhëzimet i drejtohen kishës si e tërë. Zoti nuk

do që dikush të ulet dhe të dëgjojë. Ai do që të gjithë të këndojnë.⁴ Dikush mund të ketë ose mund të mos ketë talent për të kënduar, por ai (ashtu siç e tha një shkrimtar i Dhjatës së Vjetër) mund t'i dërgojë Zotit “britma gëzimi” (Psalmëve 95:1).⁵

Këto vargje na tregojnë gjithashtu se çfarë lloj këngësh do Zoti që njerëzit e tij të përdorin në adhurim: “psalme, himne dhe këngë frymërore”. Është e vështirë të dallosh secilën kategori,⁶ por fjala kyç është “frymërore”. Këngët e përdorura në adhurim duhet t'i bëjnë thirrje mendjes dhe zemrës sonë dhe jo emocioneve të çastit.⁷

Gjithashtu, të dy vargjet tregojnë se këngët që këndojmë duhet të kenë drejtim. Nganjëherë, kristiani që këndon u drejtohet vëllezërve dhe motrave të tij në Krisht “duke i folur *njëri-tjetrit*”; “duke mësuar dhe këshilluar *njëri-tjetrin*”. Herë të tjera ato do të drejtohen lart: “duke i kënduar me gëzim *Zotit* dhe duke i dërguar britma gëzimi”; “duke kënduar dhe duke lavdëruar *Zotin* me zemër”.

Shumë këngë janë këngë për nxitje dhe thirrje, të drejtuara ndaj kristianëve apo ndaj atyre që kanë nevojë të pranojnë Krishtin:

Beso dhe bindu, sepse nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të qenë i lumtur në Jezusin, por beso dhe bindu.

Në punë! Në punë! Jemi shërbëtorë të Perëndisë
Le të ndjekim shtegun në të cilin Zoti ynë ka ecur.

Ngrihuni, ngrihuni për Jezusin!
Ju ushtarë të kryqit; . . .

Këngë të tjera janë këngë lavdërimi dhe falënderimi, të drejtuara Perëndisë dhe Jezusit:

Besimi im ngrihet drejt teje.
O qengj i Golgotës, . . .

Qëndro me mua Zot
Nuk mund të jetoj pa ty, . . .

Së fundi, këto vargje theksojnë se kristianët nuk duhet të këndojnë vetëm me buzë, por duhet të këndojnë duke lavdëruar Zotin me *zemrën* e tyre, duke i kënduar Zotit me hir në *zemrat* e tyre. Adhuresit duhet të mendojnë për fjalët që po këndojnë. Ata duhet të këndojnë “me frymën, . . . edhe me mendjen” (1 Korintasve 14:15). Kënga që nuk del nga zemra nuk arrin të ngrihet më lart

se tavani i dhomës ku po këndohet!

ÇFARË NUK DO PERËNDIA

Mund ta kini vënë re, në vargjet që kemi studiuar, se të vetmet “instrumente” të përmendura janë zërat njerëzorë dhe zemra. Nuk janë përmendur instrumentet mekanikë muzikorë.⁸ Lexoni Dhjatën e Re dhe nuk do të gjeni instrumente të përdorura në adhurim në kishën e Zotit.⁹ Harpat dhe instrumente të tjera muzikore janë përdorur në adhurimin e Dhjatës së Vjetër (për shembull te Psalmëve 150), por ato mungojnë në adhurimin kristian.¹⁰

Nga sa dimë, kristianëve të parë nuk u ishte thënë kurrë: “Nuk duhet të përdorni instrumente muzikore në adhurim.” Atëherë, pse u përjashtuan instrumentet muzikore nga adhurimi? Përgjigja e kësaj pyetje është e njëjtë në parim me atë se pse hamburgeri dhe koka-kola nuk gjenden në Darkën e Zotit. Kur Perëndia na tregon me saktësi atë që kërkon, kjo e eleminon çdo gjë tjetër në atë kategori.


Ky quhet nganjëherë “parimi i përjashtimit”. Mund të mos keni dëgjuar ndonjëherë për shprehjen “parimi i përjashtimit”, por ju e zbatoni këtë parim çdo ditë. Në qoftë se punësoni dikë që të lyejë gardhin me bojë të bardhë, nuk është e nevojshme t'i thoni: “Mos e lyej gardhin me bojë të kuqe . . . apo blu . . . apo jeshile . . . apo të zezë.” Kur cilësoni se çfarë doni dhe thoni: “lyeje me bojë të bardhë”, kjo automatikisht përjashton çdo ngjyrë tjetër.

Bibla është plot me shembuj ku ky parim përdoret. Noeut iu tha ta ndërtonte një arkë (Zanafilla 6:14). Në qoftë se do t'i thuhej vetëm “Ndërto një arkë”, ai do të mund ta ndërtonte atë prej druri apo prej hekuri.




Përkundrazi, Perëndia ishte specifik në udhëzimet që dha. Ai i tha Noeut të ndërtonte një arkë prej druri (Zanafilla 6:14). Perëndia nuk kishte


nevojë të thoshte: “Mos e ndërto atë prej hekuri apo prej ndonjë materiali tjetër.” Kur ai cilësoi prej druri, ai përjashtoi përdorimin e çdo lloj tjetër materiali.




Pak para se fëmijët e Izraelit të iknin nga Egjipti, u ishte thënë që të merrnin gjak dhe ta vinin mbi arkitraun e shtëpive në mënyrë që vdekja të mos hynte në shtëpitë e tyre, si pasojë e plagës së dhjetë të dërguar mbi Egjiptin (Eksodi 12:7, 13). Në qoftë se Perëndia do të thoshte: “Vini gjakun e një kafshe”, ata do të mund të zgjidhnin llojin e kafshës për të therur, lopë, dhi, qengj apo një lloj tjetër. Megjithatë, Perëndia në mënyrë specifike u tha të përdornin gjakun e një qengji (Eksodi 12:3, 7). Perëndia nuk tha: “Mos vini gjakun e një lope apo dhie apo ndonjë kafshe tjetër në arkitraun e shtëpive.” Kur ai tha “qengj”, kjo eliminoi çdo lloj tjetër kafshe.



Perëndia na ka urdhëruar që të pagëzohemi (Veprat 2:38). Lidhur me këtë urdhërim, në qoftë se Perëndia do të kishte thënë: “Përdorni ujë për të pagëzuar dikë”, mund ta përdornim ujin në çdo lloj mënyre që do të imagjinonim. Mund të spërkatnim ujë mbi njerëzit, mund të derdhnim ujë mbi ta apo mund t’i zhysnim ata në ujë, por, siç e kemi parë, pagëzimi biblik është zhytje në ujë. Dhjata e Re nuk ka nevojë të thotë: “Nuk duhet të spërkatni apo të derdhni ujë dhe ta quani atë pagëzim.” Kur zhytja është specifikuar, kjo e eliminon spërkatjen dhe derdhjen.



Kur Jezusi themeloi Darkën e Zotit, në qoftë se do të kishte thënë: “Përdorni një ushqim të zakonshëm për të përfaqësuar trupin tim dhe një pije të zakonshme për të përfaqësuar gjakun tim”, kisha do të ishte e lirë të zgjidhte ushqimin dhe pijen që do të përdorte. Disa mund të pëlqejnë hamburger dhe koka-kola. Të tjerë mund të pëlqejnë biskota dhe qumësht. Megjithatë, siç e kemi parë, elementet e përdorura nga Jezusi dhe kristianët e parë ishin buka pa maja dhe fryti i hardhisë.



A mund ta kuptoni se çfarë do të ishte e gabuar po të zëvendësohej buka pa maja dhe fryti i hardhisë me hamburger dhe koka-kola? A e kuptoni se do të ishte e gabuar të shtonit hamburger dhe koka-kola në tryezën e Zotit?¹¹ Nga eksperiencia ime, në qoftë se dikush nuk mund të kuptojë se do të ishte blasfemi shtimi i hamburgerave dhe koka-kolës në Darkën e Zotit, ai kurrë nuk do ta kuptojë dëmin në shtimin e instrumentave muzikore gjatë të kënduarit.

Ndoshta e keni parashikuar se si zbatohet parimi i përjashtimit në çështjen e këndimit në adhurim. Në qoftë se Perëndia do të kishte thënë: “Bëni muzikë kur adhuroni”, kisha do të këndonte, do t’u binte veglave apo do të kombinonte këto të dyja, por Perëndia e cilësoi çfarë donte. Ai tha:

... këndoj ... (Romakëve 15:9).

... këndoj ... (1 Korintasve 14:15).


. . . duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj (Efesianëve 5:19).

. . . duke kënduar Zotit me hir në zemrat tuaja (Kolozianëve 3:16).

. . . do të të lavdëroj . . . (Hebrenjve 2:12).

. . . A është i gëzuar ndokush? Le të këndojë psalme (Jakobi 5:13).

Zoti nuk ka nevojë të thotë: “Mos përdorni instrumenta mekanikë muzikorë në adhurimin kristian.” Kur cilësoi të kënduarit, kjo eliminoi çdo lloj tjetër muzike.



Kristianët e parë, siç duket, e kuptuan parimin e përjashtimit, sepse nuk përdornin në adhurimin e tyre instrumente muzikorë, megjithëse e dinin se instrumentet përdoren në adhurim gjatë kohës së Dhjatës së Vjetër. Studiuesit në përgjithësi pranojnë se adhurimi kristian ishte akapela¹² për shekuj deri sa kisha katolike prezantoi veglat në adhurim qindra vjet më vonë.¹³

KONKLUZION

Kisha duhet të këndojë jo vetëm këngë të përshtatshme për adhurim, por t'i këndojë ato edhe në mënyrën e duhur. Anëtarët duhet të kujdesen në fillim për të bërë tamam atë që Perëndia ka urdhëruar. Zemrat e tyre duhet të jepen pas adhurimit të Perëndisë në një mënyrë që është e kënaqshme për të (Efesianëve 5:10). Unë mund të mendoj se kjo apo ajo mënyrë e shprehjes së adhurimit do ta kënaqë Perëndinë, por e vetmja mënyrë për të ditur se çfarë e kënaq atë është leximi i udhëzimeve të dhëna në Fjalën e tij.

Ndërsa kristianët këndojnë, zemrat e tyre

duhet të jepen pas lavdërimit të Perëndisë (Veprat 2:47; Romakëve 14:11; 15:11; Filipianëve 1:11; Hebrenjve 13:15). Ata duhet t'i këndojnë “Zotit me hir në zemrat” e tyre (Kolozianëve 3:16). Ata duhet të këndojnë “me frymën, . . . edhe me mendjen” (1 Korintasve 14:15).

Duke pasur parasysh dy pyetjet lidhur me adhurimin, “çfarë?” dhe “pse?”, adhuruesit e vërtetë mund ta adhurojnë Perëndinë “në frymë dhe në të vërtetën” (Gjoni 4:24). ❖

¹ Shkrimtari ka cituar një varg nga Dhjata e Vjetër, Psalmeve 22:22.

² Shiko gjithashtu te Mateu 26:30.

³ Lista mund të përfshijë gjithashtu vargje që flasin për lavdërimin e Perëndisë me buzë, të tilla si Hebrenjve 13:15. Jini të kujdesshëm që t'i lexoni të gjitha këto vargje sipas kontekstit të tyre. (Kur themi kontekst i një vargu, nënkuptojmë rrjedhën e mendimit në të cilin ndodhet vargu. Kjo kërkon që të mos i lexojmë vargjet të shkëputura nga fragmenti ku ata ndodhen.)

⁴ Mund të ketë raste kur dikush nuk mund të këndojë (ai mund të ketë laringit), por këto janë përjashtime më shumë se sa rregulla.

⁵ Lexoni Psalmeve 95:1 dhe do të shikoni se dërgimi i britmave të gëzimit do të thotë të këndosh me një shprehje të lartë të ndjenjave.

⁶ Disa mendojnë se “psalmet” janë këngë lavdërimi dhe “himnet” janë më të hijshme, kurse “këngët frymërore” kanë më shumë entuziazëm. Ndoshta nuk duhet të bëjmë dallime kryesore midis të tria fjalëve. Ato janë vetëm tre këndvështrime të të njëjtit koncept të adhurimit më këngë.

⁷ Nëse një këngë i bën thirrje frymës apo mishit është çështje gjykimi, por parimi kryesor është se Perëndia do që njerëzit e tij të këndojnë këngë frymërore.

⁸ Frazja “instrumenta mekanikë muzikorë” është e gjatë dhe e pavolitshme. Për të kursyer kohë dhe vend, që këtej e tutje në këtë mësim, kur të përmend “instrumente” e kam fjalën për “instrumente mekanikë muzikorë”.

⁹ Në disa raste mund të gjeni në Dhjatën e Re përmendjen e instrumenteve mekanike muzikore, por jo në adhurimin kristian. Instrumentet janë përmendur në ilustrime (si te 1 Korintasve 13:1) dhe janë pjesë e simbolikës te Zbulesa (së bashku me erën e temjanit, si te Zbulesa 5:8). Megjithatë nuk përmendet përdorimi i instrumentave mekanike në adhurim në kishën e Perëndisë.

¹⁰ Studiuesit në përgjithësi pajtohen më këtë. Kristianët në shekullin e dytë dhe të tretë shkruan kundër muzikës instrumentale në adhurim.

¹¹ Të shtosh diçka në Fjalën e Perëndisë është një mëkat po aq i rëndë sa edhe t'i heqësh një pjesë kësaj Fjale (shiko te Zbulesa 22:18, 19).

¹² “Akapela” fjalë për fjalë do të thotë “stil kishtar”. Fjala përdoret sot për t'iu referuar muzikës që është tërësisht vokale (të kënduarit pa shoqërimin e instrumenteve muzikorë).

¹³ Përpjekje të dështuara u bënë për të futur instrumentet në vitet gjashtëqind dhe shtatëqind, por instrumentet arritën të futen në adhurimin kristian vetëm pas vitit 1250 A.D.

Autor: David Roper

Marrë nga studimi: “Udhëzues për shpëtimin e të gjithëve”

© 2001, 2003 E VERTETA PËR SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara